



BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2301/3 Prot

Rrëshen më, 30 . 07 . 2024

V E N D I M

Nr. 64 datë 26. 07. 2024

PËR
“PËRDORIM FOND REZERVË - DHËNIE NDIHMË FINANCIARE”,
BASHKIA MIRDITË.

Në mbështetje të ligjin nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", në ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", në ligjin nr. 97/2023, "Për buxhetin e vitit 2024", në Udhëzimin nr.9, datë 20.07.2018, "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", në Vendimin nr. 50, datë 15.12.2023, të këshillit bashkiak Mirditë, "Për miratimin e buxhetit të vitit 2024", relacionin nr. 2425 prot. datë 14.06.2024, dhe relacionin nr.2301/1 prot. datë 19.06.2024, së bashku me projektin e Kryetarit bashkisë, pas diskutimeve në mbledhjen e këshilli bashkiak;

V E N D O S I:

1. Të miratojë përdorimin e fondit rezervë, në shumën **50 000**, (pesëdhjetë mijë) lekë, për dhënie ndihmë financiare, si vijon;
 - ✦ T'i akordohet ndihmë financiare familjes së Znj. Arjana Vlash Loshi, njësia administrative Rrëshen, për rast fatkeqësie familjare (vdekje) dhe kushte të vështira jetese.
 - a. **Paksim:** Fondi rezervë;(A1133 00 2133001 01 V491AAA...604) në vlerën;.....**50 000** lekë.
 - b. **Shtohet:** Pagesë;(AA133 00 2133001 01 V111AAA...606) në vlerën;.....**50 000** lekë.
2. Pagesa të kalojë kryefamiljares Znj. Arjana Vlash Loshi, mbajtëse e kartës identitetit 1060080360, në degën e Postës Mirditë, zyra Postare Rrëshen.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i bashkisë Mirditë, (drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe tatim taksat).

Ky vendim, hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor, nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.

SEKRETAR

Gaspër TOPOLLAJ



KRYETAR

Aleksandër PICA KU



BASHKIA MIRDITË

Nr. 230/2 Prot.

Datw, më 19.06.2024

P/V E N D I M

Nr. 71 datë 19.06.2024

“PËR PËRDORIM FOND REZERVË”

Mbështetur në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në ligjin Nr.9936 datë 26.06.2008 ‘Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë’, në ligjin Nr.68/2017 ‘Për financat e vetëqeverisjes vendore’, në ligjin Nr.97/2023, ‘Për buxhetin e vitit 2024’ ‘Udhëzimin Nr.9 datë 20.07.2018 ‘Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit’, në udhëzimin Nr.1 datë 24.01.2024, ‘Për zbatimin e buxhetit 2024’, në VKB Nr.50 datë 15.12.2023 ‘Për miratimin e buxhetit të vitit 2024’, në relacionin Nr.2425 prot, datë 14.06.2024 e sektorit të shërbimit social të NJA Rrwshe, Bashkia Mirditë, këshilli I bashkisë Mirditë pasi diskutoi rreth projektit të paraqitur nga Kryetari I bashkisë:

V E N D O S I :

I-Të përdorë nga fondi Rezervë shumën 50 000 lekë, për dhënie ndihmë financiare si më poshtë:

1.Të japë ndihmë financiare, familjes së Znj.Arjana Vlash Loshi, NJA Rrëshen për kushte të vështira jetese..

a-Paksim : Fondi rezervë (AII33 00 2133001 01 V491AAA.604)për shumën 50 000 lekë

b-Shtohet;(AA133 00 2133001 01 V111AAA.....606) për shumën50 000 lekë

2.Pagesa të kalojë në degën e Postës Mirditë, zyra Postare Rrëshen.

II- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet sektori I finacës dhe buxhetit.

III- Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

KRYETARI

Gaspër TOPOLLAJ

Aleksandër PICAKU

Paraqitën projektin

Dr/zhvill ek dhe tatim taksat: V.Gjoka

Dr.Juridike,prok,protokoll : B.Dedaj

KRYETARI
Albert MËLYSHI



ADRESA: SHESHI “ABAT DOÇI”, RRESHEN

email: bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel & fax : +355 216 22233

web: www.bashkiamirdite.gov.al



BASHKIA MIRDITË

DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE TATIM TAKSAVE

Nr. 2301/Prot.

Rrëshen me 19.06 2024

RELACION

MBI PËRDORIMIN E FONDIT REZERVE

Në mbështetje të udhëzimit Nr.9 datë 20.07.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit”, në udhëzimin nr. 1 dt.24.01.2024 “Për zbatimin e buxhetit 2024” në VKB nr.50 datë 15.12.2023 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2024” si dhe në relacionin e Sektorit të Shërbimit Social të Bashkisë ju sqarojmë si më poshtë:

Znj.Arjana Vlash Loshi NJ.A Rrëshen me shkresën Nr.2301 prot. dt.07.06.2024 i është drejtuar Kryetarit të Bashkisë për dhënie ndihmë financiare familjes . Sektori i Ndihmës Ekonomike të Njesisë Administrative Rrshen ka bërë vlerësimin social – ekonomik për këtë familje. Duke qenë se familja jeton në kushte të vështira ekonomike dhe meqenëse ju ka ndodhur dhe fatkeqësi.i kërkojnë Bashkisë që të ndihmojë këtë familje me ndihmë financiare për të zbutur sado pak këtë situatë .

Duke parë gjendjen ekonomike të znj.Arjana Loshi Bashkia propozon një ndihmë financiare nga fondi Rezervë për të përballuar situatën ekonomike sociale në shumën 50 000 (Pesëdhjetë mijë) lekë.

Konc: Vjollca Gjoka

MIRATOI

KRYETARI

Albert MËLYSHI





BASHKIA MIRDITË

SEKTORI I NDIHMËS EKONOMIKE

Nr. 2425 Prot.

Rrëshen më, 14 06 2024

RELACION

“VLERËSIM SOCIO-EKONOMIK I FAMILJES SË Zj. ARJANA VLASH LOSHI”

Nisur nga kërkesa e drejtuar Bashkisë Mirditë nga vetë zonja Arjana Loshi me datë 06.06.2024 ardhur në bashkinë tonë me datë 07.06.2024 me Nr.2301 Prot. vlerësojmë si më poshtë:

Arjana Loshi është më status e ve, pasi para 16 vitesh ka humbur tragjikisht në një aksident automobilistik Kryefamiljarin Anton Nikoll Loshi, duke lënë pas dy fëmijë të mitur, djalë dhe vajzë përkatësisht 8 vjeç dhe 6 vjeç. Që prej asaj kohe kanë nisur problemet ekonomike të familjes. Deri para tre vitesh Arjana bashkë me fëmijët kanë qënë me banim në Rrëshen. Duke mos patur një banesë të vetën, shpesh herë ka ndërruar shtëpi të ndryshme me qera. Është trajtuar me bonus qeraje nga Bashkia deri në dhjetor të vitit 2021. Për shkak të problemeve ekonomike është trajtuar edhe me ndihmë ekonomike që prej shkurtit 2019 deri në nëntor 2021, kur është penalizuar për mosparaqitje për të firmosur deklaratën tre mujore. Sipas verifikimeve të bëra edhe në zyrën e punës Arjana nuk rezulton e punësuar.

Pavarësisht problemeve ekonomike në Maj të këtij viti i ka ndodhur edhe një fatkeqësi tjetër. Vajza e saj Aldorjana i ka dhënë fund jetës për arsye të paqarta. Për arsye të fatkeqësive mendojmë që kjo familje të ndihmohet me një ndihmë financiare, sipas mundësive që Bashkia ka në buxhet.

Bashkëngjitur po ju dërgojmë edhe çertifikatën familjare të zonjës.

Konceptoi: Përgj/Sektorit të Nd. Ek. e Shërbimit social: Gjergj PËRGJONI

Miratoi: Drejtori Aurel ÇUPI

KRYETARI

Albert MËLYSHI

